

CIRCULAR CITY



Maja Djolic, Aleksandra Vucinic,
Natasa Atanasova and Guenter Langergraber

Book title: Circular City

Authors: Maja B. Đolić and Aleksandra Vučinić, Nataša Atanasova and Günter Langergraber

Translated in Albanian by: Eriona Canga, Alchemia-nova GmbH, Institute for circular economy & nature-based solutions

Illustrations: Ana Popović (Inst@ananana_14, @ananana_design)

Illustration of Cover page: Tea Nikolić (Inst@prismriver_)

©Circular City COST Action CA17133

Grant Holder Institution:

Universität für Bodenkultur Wien (BOKU)

Department of Water, Atmosphere and Environment

Institute of Sanitary Engineering and Water Pollution Control

Muthgasse 18, 1190 Vienna, Austria

Chair of the Action:

Dr. Guenter Langergraber

Head, Department of Water, Atmosphere and Environment

guenter.langergraber@boku.ac.at

Co-Chair of the Action:

Dr. Nataša Atanasova

University of Ljubljana, Faculty of Civil and Geodetic Engineering

natasa.atanasova@fgg.uni-lj.si

Reuse is authorized provided the source is acknowledged. It can be used for educational purposes for the appropriate reference.

This publication is based upon work from COST Action CA 17133 "Implementing nature based solutions for creating a resourceful circular city (Circular City Re.Solution)" supported by COST (European Cooperation in Science and Technology).

COST (European Cooperation in Science and Technology) is a funding agency for research and innovation networks. Our actions help connect research and initiatives across Europe and enable scientists to grow their ideas by sharing them with their peers. This boosts their research, career and innovation.

www.cost.eu



COST Action CA17133


Grant Holder Institution:



NJE DITE E BUKUR PLOT DIELL

Një ditë prej ditësh duke ecur në rrugë, teksa ktheheshin për në shtëpi, Ana dhe Luka po rrëfenin të lumtur se çfarë u kishte ndodhur në shkollë. Ata po qeshnin me ndodhitë dhe po shijonin gurgullimën e gëzuar të lumit të qytetit, të cilin të dy e donin shumë.

Biseda gazmore u zëvendësua nga tema serioze. Duke parë valët e lumit të gëzuar, Ana i tha Lukës: "A e di sa i rëndësishëm është uji për trupin tonë? Deri në 70% të trupit të njeriut përbëhet nga uji".



"Një njeri mund të jetojë deri në njëzet ditë pa ushqim, por vetëm tre ditë pa ujë! Ne as që jemi të vetëdijshëm se sa i rëndësishëm është uji për të gjitha qëniet e gjalla."






"Ne i shkarkojmë ujërat e zeza ose të ndotura nga banesat tona dhe impiantet industriale drejtpërdrejt në rrugët natyrore ujore, përrenj, lumenj dhe liqene. Duke vepruar kështu, ne po rrezikojmë të gjithë organizmat që jetojnë në ujë: gaforret, peshqit, të gjithë botën e bimëve ujore, si dhe gjallesat e tjera që varen nga uji, por nuk jetojnë në të."



"Gjithashtu, nuk është mirë që bretkosat në breg të kenë ujë të ndotur."



"Gjithçka mund të ishte ndryshe nëse ne njerëzit do ta pastronim ujin që kemi përdorur përpara se ta derdhim në rrugët ujore. Në këtë mënyrë, do të ruanim ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore për brezat e ardhshëm. Uji është një nga burimet më të rëndësishme në planetin Tokë."



Ndërsa dëgjonte Anën me kërshtëri, Luka papritur rëshqiti dhe për pak u rëzua përdhe. Për fat të mirë, Ana zgjati dorën e saj drejt Lukës, ariti ta mbante atë dhe ta ndihmonte të mos lëndohej.



Luka u kthye për të parë se çfarë e kishte penguar në rrugën e tij – dhe ç'të shihte, ai pa një shishe plastike që rrotullohej në trotuar.



"Nuk arrij ta kuptoj pse dikush ka hedhur mbetje plastike në trotuarin ku ecin njerëzit. Dikush mund të pengohet, bie dhe lëndohet", i tha Luka Anës.

"A e di ai i paedukatë se plastika i duhen mbi 100 vjet për t'u dekompozuar në natyrë?!"



"Plastika mund të riciklohet dhe prej saj mund të formohet një produkt i ri. Dhe kjo nuk është aspak e vështirë. Duhet vetëm që mbetjet plastike të hidhen në vendin e caktuar, një kontejner ose një kosh riciklimi. Unë e bëj këtë gjatë gjithë kohës dhe nuk është e vështirë për mua që t'i ndaj mbeturinat në kosha të vecantë për letër, metal, plastikë dhe xhami."





"Në këtë mënyrë, ne do të zvogëlonim ndikimin tonë në ndryshimet klimatike. Thatësiirat dhe përmytjet e forta janë rezultat i aktiviteteve njerëzore që ndryshojnë klimën. Këto ndryshime mund të çojnë edhe në zhdukjen e disa llojeve bimësh e kafshësh", përfundoi Luka.

“Ana, ne po shpërdorjmë burimet natyrore: ujë, minerale, rërë e zhavorr, pyje... Ne kemi vetëm një planet, ama tani ne po i tej përdorim burimet e tij sikur të kishim dy planete. Prej kohësh jemi duke përdorur më shumë se sa na duhet. dhe ne po marrim edhe ato burime që i takojnë brezave që vijnë. Çfarë të ardhmeje do t'u lëmë atyre, nëse shkatërrojmë të vetmen shtëpi ku ata mund të jetojnë?”





Teksa ata po flisnin, papritur filloi të bjerë shi, kështu që Ana dhe Luka vrapuan në parkun më të afërt për t'u fshehur nën kurorën e një peme.




Ana i tha Lukës: "Unë e dua shumë natyrën, por unë e dua edhe qytetin tim. Në natyrë, mua më pëlqejnë pemët, bari dhe gjelbërimi, dhe në qytet, unë dua shkollën time, miqtë e mi, më pëlqen të bëj xhiro me biçikletë, lojërat me top... Mua do të më pëlqente shumë më shumë nëse mund të bashkoja natyrën dhe qytetin, diçka si një qytet natyror."



Luka u përgjigj: "Në ditët e sotme, kjo mund të arrihet lehtësisht". Nëse të gjithë bëjmë përpjekje, ne mund të jetojmë në një qytet të gjelbër. Unë nuk e di nëse e dinit që edhe muret dhe çatitë mund të bëhen të gjelbra?

Imagjinoni që bima apo lulja juaj e preferuar të rritet në një mur ose një çati. Ose imagjinoni pak luleshtrydhe të shijshme të kuqe duke u rritur në mure ose çati rreth jush. A nuk do të ishte e mrekullueshme?"





"Kjo tingëllon fantastike," tha Anna me entuziazëm. "Unë do të mbillja margarita; Mua më pëlqejnë shumë ato. Për mamin tim, do të mbillja barishte aromatike, rigon ose borzilok, ajo i përdor ato shumë në gatimet që bën. Sa bukur do të ishte e gjitha kjo!"



"Ne mund të rritim bimët tona të preferuara, ndërsa muret e gjelbërta dhe kopshtet e çatisë na mbrojnë nga ndryshimet e temperaturës. Shtëpia jonë është më e ngrohtë në dimër dhe më e freskët në verë. Në këtë mënyrë ne kursejmë energji dhe zvogëlojmë ndikimet e ndryshimit të klimës."



Shiu pushoi dhe Ana e Luka vazhduan shëtitjen në park. Pastaj panë disa miq të shkollës të cilët ishin ulur në një stol dhe po shijonin frutat e tyre.



Ana u tha atyre: "A e dini se një e treta e ushqimit të prodhuar në botë hidhet dhe shpërdorohet? Imagjinoni sikur t'ua jepnim të gjithë atë ushqim të tepërt atyre në nevojë, ose ta përdornim për ndonjë qëllim tjetër. Kjo lëvozhgë bananeje dhe mbetje molle mund të jetë ushqim për bimët. Natyra na ushqen, dhe ne ushqejmë natyrën. Një rreth ripërdorimi i burimeve tona perfekt! Në fakt, natyra ka një zgjidhje për gjithçka. Do të ishte mirë nëse do të mund t'i bindnim të gjithë miqtë tanë për një mënyrë të tillë jetese, dhe për të pasur sukses në këtë, ne duhet të edukojmë veten."



Luka u përgjigj: "Po, unë do të doja të isha arkitekt dhe ta ndërtoja ndërtesën time të gjelbër!". Ana shtoi: "Kjo është një ide e mrekullueshme! Dëshira ime është të jem biologe dhe të studioj natyrën." Arbri u bashkua: "Unë do të bëhem inxhinier dhe do të ndërtoj impiante për trajtimin e ujërave të zeza!" Duke dëgjuar me padurim miqtë e saj, Mia më në fund tha: "Dhe unë do të bëhem një ekonomiste që t'ju ndihmoj të gjithëve që të krijoni një qytet rrethor së bashku."







KËSHILLA PËR ADHURVESIT E VËRTETË TË NATYRËS

- Mësoni diçka më shumë për qytetet rrethore duke parë videon: <https://www.youtube.com/watch?v=R3NXLb-W1pg>
- Përveç rigonit dhe borzilokut, ka edhe disa barishte të tjera aromatike. Zbuloni disa prej tyre dhe kërkojini ato në rrethinën tuaj!
- Mbillni një pemë në mjedisin tuaj, kujdesuni për të dhe ushqejeni atë! Lëreni të rritet së bashku me ju! Ndani mbetjet dhe hidhini në kosha të dedikuar për mbetjet e riciklueshme!
- Mundohuni të bëni diçka të dobishme për mjedisin çdo ditë!
- Kurseni ujin! Nëse nuk e mbyllni rubinetin e ujit gjatë larjes së dhëmbëve, rreth 11 litra ujë i pastër do të rrjedhë nga rubineti për pak minuta. Sigurohuni që ta mbyllni rubinetin gjatë larjes së dhëmbëve!
- Kurseni energjinë elektrike! Fikni dritat dhe pajisjet elektrike kur dilni nga dhoma ose nuk keni nevojë për ato!
- Zbuloni tema në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe organizoni me miqtë tuaj leksione për fqinjët e vegjël. Lëreni këtë libër për fëmijë t'ju ndihmojë me këtë!
- Mundohuni të kaloni sa më shumë kohë në natyrë. Gëzohuni dhe qeshni!



PËR DETECTIVËT E VOGËL - GJENI 5 NDRYSHIME





VIZATO TUAJ
CIRCULAR CITY

